

Zyra Kryetari



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA			
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA			
Pranuar - Përmirëso tërësisht/Dana		29.09.2022	
Nr. i organit Org. broj	Numri/Droj	Shërbimi Prilog	Vlera Vrednues
01-110/05-1065			



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality Viti/na

Në bazë të nenit 12, pika d, neni 40, pika j të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), neni 7 të Ligji Nr.04/L-010 për Bashkëpunim Ndërkomunal dhe neni 36, shkronja d të Statutit të Komunës së Vitisë 01 Nr. 013/491, të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë, në mbledhjen e mbajtur më datën 28.09.2022, merr këtë:

VENDIM

Për autorizimin e kryetarit të Komunës së Vitisë për bashkëpunim ndërkomunal me Komunën e Klllokotit në fushat e përgjithshme, si: infrastrukturë rrugore, ekonomi, bujqësi, shëndetësi, arsim, shërbime të zjarrfikëseve, ofrimi i shërbimeve juridike

Neni 1

Me këtë, Kuvendi i Komunës së Vitisë miraton vendimin për AUTORIZIMIN e kryetarit të Komunës së Vitisë, për të filluar konsultimet me Komunën e Klllokotit për bashkëpunimin ndërkomunal në fushat e përgjithshme, si: infrastrukturë rrugore, ekonomi, bujqësi, shëndetësi, arsim, shërbime të zjarrfikëseve, ofrimi i shërbimeve juridike.

Neni 2

Pas marrjes së autorizimit, kryetari i Komunës së Vitisë e njofton kryetarin e Komunës së Klllokotit, për nismën me të cilin kërkohet themelimin i bashkëpunimit ndërkomunal.

Neni 3

Ky vendim prodhon efekt juridike deri në përfundim të këtij mandati të Kryetarit të Komunës së Vitisë.

Neni 4

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, në kuptim të nenit 81 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), neni 8 lidhur me neni 9 të Rregullores Nr.10/2019 për procedurat e hartimi dhe publikimi të akteve të Komunave dhe pas publikimit në web faqen e Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Zyrës së Kryetarit;
2. MAPL-së; dhe
3. Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË
K R Y E S U E S I

Bekim Azizi

